

Përdorimi mesatar i qeseve plastike në Maqedoninë e Veriut

bazuar në kërkimet e kryera në terren


Dokument i shkurtër për politikë publike

Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI) në vitin 2019 nisi bashkëpunim me qendrat analitiko-hulumtuese të partive (QAHP ose qendrat hulumtuese) të katër partive politike me përfaqësimin më të shumtë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe Lëvizjen BESA. Përmes një sërë trajnimesh, IRI mundësoi mbështetje për forcimin e kapaciteteve të personelit të këtyre qendrave për sondazhe të opinionit endimit publik, planifikimin strategjik, analizën dhe zhvillimin e politikave publike. Në fushën e analizës dhe zhvillimit të politikave publike, përveç trajnimeve të kryera, qendrat hulumtuese me mbështetjen e IRI dhe anëtarëve të komisioneve partiake përpiluan një dokument të përbashkët për politikë publike për përdorimin e qeseve plastike ku analizohet problemi i përdorimit të qeseve plastike si dhe i mbeturinave nga qeset plastike, që përmban propozim të përbashkët për masat për të zvogëluar përdorimin e qeseve plastike.

Me qëllim të informimit më të mirë dhe marrjes së provave gjithëpërfshirëse, mbi të cilat do të bazohen propozim-masat dhe politikat për zvogëlimin e përdorimit të qeseve plastike, përfaqësuesit e katër qendrave hulumtuese të partive, me mbështetjen e IRI, së bashku, përgatitën një pyetësor sondazhi që mat përdorimin mesatar të qeseve plastike nga konsumatorët. Këto pyetje të përbashkëta ishin pjesë përbërëse e sondazhit të opinionit publik të IRI, të [zhvilluar nga 30 janar deri më 10 shkurt të vitit 2020](#). Kjo përmbledhje e shkurtër synon të paraqesë gjetjet kryesore, qëndrimet dhe rekomandimet që rrjedhin nga përgjigjet e dhëna që do të modelojnë fotografinë e konsumit mesatar të qeseve plastike të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut dhe në këtë mënyrë të informojnë më saktë hartuesit e politikave për të marrë masa gjithëpërfshirëse.

Përdorimi mesatar i qeseve plastike për një përdorim

Mesatarisht, qytetarët e Maqedonisë së Veriut përdorin 2,15 qese plastike për një përdorim çdo ditë. Kjo domethënë se në nivel mujor një qytetar përdor mesatarisht 64,5 qese plastike për një përdorim, kurse në nivel vjetor 784,75 qese.



Popullata e re përdor mesatarisht më shumë qese plastike në ditë sesa popullata më e moshuar dhe ky trend është në përpjesëtim të kundërt me moshën. Grupmosha 18-35 përdor mesatarisht 2,43 qese plastike në ditë, grupmosha 36-55 përdor 2,30 qese plastike në ditë, ndërsa popullata mbi moshën 56-vjeçare përdor mesatarisht 1,71 qese plastike në ditë. Dallimi në numrin e qeseve midis grupeve të ndryshme etnike është i dukshëm: **maqedonasit etnikë përdorin mesatarisht 1,92 qese plastike në ditë, ndërsa shqiptarët etnikë përdorin 2,79 qese në ditë.** Ky numër në bashkësitë e tjera etnike është 2,08 qese në ditë. Sipas statusit të punës, **më së shumti qese plastike përdorin amvisët/et (2,60 në ditë; 949 në vit),** pastaj nëpunësit (2,47) dhe punëtorët (2,41). **Përdorimi më i ulët i qeseve plastike për një përdorim në bazë ditore vërehet tek pensionistët (1,53 në ditë; 558,45 në vit).** Gjithashtu vërehet një trend shkallor i rritjes së përdorimit mesatar të qeseve plastike në proporcion të drejtpërdrejtë me madhësinë e të ardhurave mujore individuale. Kështu, të anketuarit që kanë të ardhura nga 0 deri në 18.000 denarë përdorin mesatarisht 1,99 qese në ditë, të anketuarit me të ardhura nga 18.001 deri në 36.000 denarë përdorin mesatarisht 2,34 qese, ndërsa të anketuarit që kanë të ardhura mbi 36.001 denarë, përdorin 2,83 qese në ditë. Gjeografikisht, qeset plastike për një përdorim më së shpeshti përdoren nga qytetarët në zonën e parë zgjedhore (2,37 në ditë) dhe në të gjashtën (2,76 në ditë), dhe më së paku në zonën e dytë (1,84) dhe të tretën (1,81). **Burrat (2,17) dhe gratë (2,12) përdorin pothuajse të njëjtin numër të qeseve.**

Hudhja e plehrave amvisërore

Qytetarët në përmasa të mëdha përdorin qese plastike nga blerja për hudhjen e mbeturinave të amvisërisë. 52% e të anketuarve hedhin mbeturina vetëm në qese plastike, ndërsa 22% e të anketuarve i hedhin edhe në qese plastike edhe në qese plastike të parapara enkas për ruajtjen e mbeturinave. **Qytetarët me të ardhura më të mëdha më së shumti hedhin mbeturina në qese të posaçme të parapara për atë qëllim, ndërsa qytetarët me të ardhura më të ulëta hedhin më shumë mbeturina në qese plastike nga blerja.**


A e ndotin mjedisin jetësor qeset plastike?

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se ekziston vetëdije për ndotjen e mjedisit nga qeset plastike. 62% u përgjigjën se në mënyrë të konsiderueshme e ndotin mjedisin, me pasoja të dëmshme për të, kurse 29% u përgjigjën se e ndotin mjedisin, por jo në mënyrë të konsiderueshme. Vetëdije më të madhe për ndikimin negativ të qeseve plastike kanë të anketuarit nga njësia e tretë zgjedhore.


Vetëm 6% e të anketuarve kanë thënë se qeset plastike nuk e ndotin mjedisin.

Sipas juve, sa e ndotin (nëse e ndotin) mjedisin jetësor qeset plastike / bioshpërbërëse?

Qeset plastike



Qeset bioshpërbërëse



- E ndotin mjedisin në mënyrë të konsiderueshme, me pasoja të dëmshme
- E ndotin mjedisin, por jo në mënyrë të konsiderueshme
- Nuk e ndotin mjedisin
- Nuk e din/Refuzon të përgjigjet



A e ndotin mjedisin jetësor qeset bioshpërbërëse?

Ekziston një perceptim midis qytetarëve që qeset bioshpërbërëse ndotin mjedisin jetësor më pak se qeset plastike për një përdorim, megjithëse nuk ka prova shkencore për bioshpërbërjen e tyre të plotë në një kohë të arsyeshme, në deponi ose në një mjedis ujor, ku ato më së shpeshti përfundojnë. 30% u përgjigjën se e ndotin mjedisin në mënyrë të konsiderueshme, ndërsa 40% u përgjigjën se e ndotin mjedisin, por jo në mënyrë të konsiderueshme. Për shkak të kësaj ato nuk janë zgjidhje e përshtatshme për mjedisin jetësor.

Në mjediset rurale, vërehet njohje më e madhe mbi efektet negative të qeseve bioshpërbërëse, 14% më shumë sesa të anketuarit nga mjediset urbane.

Ekziston injorancë më e madhe në lidhje me ndikimin negativ të qeseve bioshpërbërëse mbi mjedisin. Gjithsej 19% e të anketuarve janë përgjigjur se qeset bioshpërbërëse nuk e ndotin aspak mjedisin, me një përqindje më të lartë të maqedonasve etnikë (21%) sesa të shqiptarëve etnikë (11%).

11% e të anketuarve thanë se nuk e dinin nëse qeset bioshpërbërëse e ndotin ose nuk e ndotin mjedisin. Pjesa më e madhe e qytetarëve që nuk e dinin efektin e qeseve bioshpërbërëse janë nga njësia e parë dhe e dytë zgjedhore.

Cilat janë masat më të mira për të zvogëluar përdorimin e qeseve plastike?

Të pyetur që të zgjedhin dy nga tre masat e propozuara për të zvogëluar përdorimin e qeseve plastike, qytetarët në mënyrë të barabartë zgjedhin **ndalimin e tërësishëm të përdorimit të qeseve plastike (50%) dhe inkurajimin e përdorimit të torbave të ripërdorshme (50%).** Pjesa më e madhe e të anketuarve etnikë shqiptarë janë në favor të ndalimit të përdorimit të qeseve plastike, kurse më shumë qytetarë etnikë maqedonas mbështesin inkurajimin e përdorimit të torbave për përdorim të shumëfishtë.

Torbat për përdorim të shumëfishtë preferohen nga popullata më e moshuar (56%) në krahasim me popullatën më të re (42%).

Ndër shqiptarët etnikë, pagesa e detyrueshme për qese plastike (25%) ka një mbështetje pak më të lartë si masa më e mirë në krahasim me maqedonasit etnikë (15%). Kjo masë ka mbështetjen më të madhe në njësinë e gjashtë zgjedhore.

Konkluzione dhe rekomandime për politikëbërësit: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe palët e tjera

Konkluzionet dhe provat nga sondazhi i zhvilluar japin një bazë solide për futjen në përdorim të propozim-masave të përgatitura paraprakisht nga katër qendrat hulumtuese. Në atë drejtim:

- **Në vend ka kushte dhe duhet të vendoset një ndalesë e plotë për përdorimin e qeseve plastike për një përdorim.** Duke pasur parasysh përdorimin e tepërt të qeseve plastike për një përdorim (64,5 qese në muaj; 785 qese në vit), por njëkohësisht edhe vetëdijen e lartë të qytetarëve për ndikimin e tyre të dëmshëm mbi mjedisin (91% janë të vetëdijshëm që qeset plastike për një përdorim ndotin mjedisin), një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve e identifikojnë këtë masë si një nga më efikasat për zvogëlimin e përdorimit të qeseve plastike.
- **Duhet të ndryshohet perceptimi që qeset bioshpërbërëse ndotin më pak ose nuk e ndotin mjedisin jetësor.** Të intensifikohet edukimi mbi efektet e dëmshme të qeseve bioshpërbërëse dhe të vendoset pagesa e detyrueshme dhe çmimet e larta për këtë lloj qese që do të lejohen për qarkullim. Qytetarët mund të pritët të vazhdojnë të përdorin këtë lloj qese për grumbullimin e mbeturinave në amvisëri.
- **Duhet të inkurajohet përdorimi i torbave të ripërdorshme për blerje, veçanërisht në mesin e popullatës më të re.**